

681; Politika, Dragan Stojanović, përkujtimi në shtyp, FDH-27473; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832.

Bekim (Dalip) Bekteshi

(6.08.1971, shqiptar nga Samadrxha/Samodraža, komuna e Suharekës/Suva Reka, teknik bujqësor, i martuar, pjesëtar i UÇK-së)

Bekimi ka marr pjesë në protestat kundër pezullimit të autonomisë së Kosovës në vitin 1989. Ka qenë anëtar i *Lëvizjes Popullore për Çlirimin e Kosovës* që nga viti 1997. Ka aderuar në radhët e UÇK-së në muajin qershor të vitit 1998. Ka rënë më **19.08.1998**, gjatë betejës me forcat serbe në fshatin **Samadrxhë/Samodraža**, ku edhe u varros një ditë më vonë. Pas përfundimit të luftës, më 19.09.1999, mbetjet mortore të Bekimit u rivarrosën në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Suharekë/Suva Reka.

Burimet: deklarata S.H, FDH-36854; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.241 A, FDH-5838; fotografi, FDH-20988; SHFDUÇK, *Feniksët...3*, 259-261; *Serb Forces Shell Rahovec and Suhareka Villages*, newsletter, KIC, 20.08.1998, FDH-29444; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; UÇK, *Lista e deshmoreve...*, FDH-36427.

Jahir (Ejup) Sylaj

(15.05.1937, shqiptar nga Sllapuzhani/Slapuzhane, komuna e Suharekës/Suva Reka, tregtar, tetë fëmijë)

Remzi (Hajdar) Sylaj

(8.04.1958, shqiptar nga Sllapuzhani/Slapuzhane, komuna e Suharekës/Suva Reka, punëtor, shtatë fëmijë)

Në fillim të muajit gusht të vitit 1998, familja e Jahirit e ka braktisur fshatin, ndërkaq ai me djalin e vëllait Remziun kanë mbetur në **Sllapuzhan/Slapuzhane**. Vëllai i tij, Avdiu, i ka vizituar Jahirin dhe Remziun më **21.08.1998**. Gjatë sulmit të forcave serbe ndaj fshatit më 23.08.1998, Avdiu i ka gjetur trupat e pajetë të Remziut dhe Jahirit në dalje të fshatit, pranë rrugës për Bllacë/Blace. Remziu i kishte plagët në kokë, ndërkaq Jahiri nëpër trup. Pjesëtarë të UÇK-së i kanë ndihmuar Avdiut në varrosjen e të birit dhe të vëllait në një vend, afro 300 metra larg vendit ku e kishin humbur jetën. Pas përfundimit të luftës, në muajin korrik të

vitit 2000, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet e tyre mortore në varrezat e fshatit.

Burimet: deklarata S.N, FDH-10687; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.241 A, FDH-5838; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.D00697, FDH-35626; fotografi, FDH-20985.

Goran (Zlatibor) Andrić

(6.11.1975, serb nga Saranova, komuna e Raçës, i pamartuar, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Gorani e ka kryer shkollën e mesme bujqësore në Topollë. Në fillim, punonte me të atin në kompaninë *11 Tetor* në Raçën e Kragujevcit. Pas trajnimit të kryer policor në Novi Sad në muajin gusht të vitit 1997, ka nisur nga puna në njësitin për intervenime në Beograd. Shpesh shkonte me detyrë në Kosovë, ndërkaq herën e fundit më 9.08.1998. Ka gjetur vdekjen më **23.08.1998** në fshatin **Duhël/Dulje**, gjatë betejës me forcat e UÇK-së. E kanë varrosur më 25.08.1998 në varrezat e fshatit të Saranoves.

Burimet: deklarata Z.A, FDH-31383; SMIP, *Terroristički...*, III, 480, 939; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 11.

Mehmet (Misin) Bytyqi

(23.03.1968, shqiptar nga Reshtani/Raštane, komuna e Suharekës/Suva Reka, punëtor, një fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Shaban (Islam) Gashi

(9.09.1972, shqiptar nga Reshtani/Raštane, komuna e Suharekës/Suva Reka, punëtor ndërtimor, një fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Mehmeti dhe Shabani filluan të vepronin si ushtarë të UÇK-së nga mesi i muajit qershor të vitit 1998. Për detyrë e kishin vëzhgimin dhe mbajtjen e rojës përreth fshatit të vet **[Reshtan/Raštane]**. Në datën **23.08.1998**, pjesëtarë të forcave serbe e kanë sulmuar fshatin. Mehmeti dhe Shabani me një grup ushtarësh të UÇK-së gjendeshin te pozicioni i quajtur *Pika e Lonit/Ljonijeva osmatračnica* dhe u ndihmonin civilëve që po e braktisnin fshatin. Nga ora 14:00, Mehmetin e kanë qëlluar me pushkë snajperi në krah. Bashkëlufëtaret Refkiu dhe Shabani tentuan t'i ndihmonin. Përderisa Shabani po i afrohej Mehmetit, një granatë e ka pla-